

**AKT THEMELIMI**  
**I**  
**SHOQËRISË MË PËRGJEGJËSI TË KUFIZUAR**  
**“AD PACK” Sh.p.k.**

Sot, më datë 04/11/2022 (dymijë e njëzet e dy), ortaket themelues:

**Gëzim SHEHU**, shtetas shqiptare, i biri i Fatmir, lindur më lindur në Tepelenë, më datë 19/03/1986, banues në Rr. Lord Bajron, Njesia Asdministrative nr 11, Tirane, mbajtës i letërnjoftimit me nr. 035197607 dhe nr personal I60319022K, madhor me zotësi të plotë juridike për të vepruar;

**Saimir SHEHU**, i biri i Fatmir, shtetas Shqiptar, lindur në Tepelenë dhe banues në Tiranë, lindur më 18/10/1989, madhor, me zotësi të plotë juridike për të vepruar, për identitetin e të cilit u garantova me pasaporte nr. BA0048719 dhe nr. personal I91018052W, te cilet

Vendosen themelimin e shoqërisë “AD PACK” Sh.p.k., përmes ketij akt-themelimi

**NENI 1**

Shoqëria Tregtare “AD PACK” Sh.p.k., themelohet në formën e një Shoqërie me përgjegjësi të kufizuar, në përputhje me ligjin 9901, datë 14/04/2008 “Për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare”, (këtu e më poshtë Shoqëria). Shoqëria është një person juridik Shqiptar.

**NENI 2**

**Emri dhe vula e shoqërisë**

Shoqëria, do të dalë në qarkullimin juridiko - civil me emrin “AD PACK” Sh.p.k. Ajo do të ketë edhe vulën e saj.

**NENI 3**

**Objekti i veprimtarisë**

Shoqëria ka per objekt veprimtarie:

- Përpunim të çantave të letrës, kartoni, import eksport.
- Printim i çantave të letrës dhe kartonit.
- Printim dhe përpunim i kutive të ndryshme letër dhe karton.

Shoqëria ka të drejtë të ushtrojë çdo lloj aktiviteti të parashikuar nga ligji në përputhje me rregullat e dispozitat në fuqi. Shoqëria do të ushtrojë aktivitetin e saj në bazë të autorizimeve dhe/ose lejeve përkatëse të lëshuara nga organet kompetente të fushës.

**NENI 4**

**Selia e Shoqërisë**

Selia e Shoqërisë ndodhet në adresën Durrës, Shkozet, Lagjja 14, pasuri e ndodhur ne Zone Kadsatrale 8516, me kod unik 85160211185.

**NENI 5**

**Kapitali i Shoqërisë**

Kapitali themeltar i shoqërisë përbëhet nga kontributi në para i ortakeve themelues. Kontributi në para do të ketë vlerën prej 100.000,00 (njëqind mijë) Lekë.

Ortaket themelues te Shoqërisë zotërojne dy kuota në shoqëri si më poshtë:

- **Gëzim SHEHU**, i biri i Fatmir, në cilësinë e ortakut zotëron 50% të vlerës së kapitalit themeltar të Shoqërisë të barabartë me 1 kuotë ne vlerë prej 50.000,00 (pesëdhjetë mijë) Lekë.
- **Saimir SHEHU**, i biri i Fatmir, në cilësinë e ortakut zotëron 50% të vlerës së kapitalit themeltar të Shoqërisë të barabartë me 1 kuotë ne vlerë prej 50.000,00 (pesëdhjetë mijë) Lekë.

Kapitali themeltar është derdhur në total nga ortaket themelues. Vlerësimi dhe pagesa e kapitalit themeltar është kryer nga ortaket me miratimin e këtij Akti.

#### NENI 6

##### Kohëzgjatja e shoqërisë

Afat kohor i zhvillimit të aktivitetit të shoqërisë është i pa përcaktuar.

#### NENI 7

##### Organet Drejtuese

Duke ju referuar ligjit nr. 9901, datë 14/04/2008 "Për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare", organet drejtuese të shoqërisë janë si më poshtë vijon:

1. Asamblea e Përgjithshme e Ortakëve – organi më i lartë vendimarrës;
2. Administratorët – organi ekzekutiv dhe administrativ i shoqërisë.

Organizimi dhe funksionimi i këtyre organeve është përcaktuar në statutin e shoqërisë. Shoqëria administrohet nga Administratorët të cilët zgjidhen për një mandat pesëvjeçar me të drejtë rizgjedhjeje.

Administrator i Shoqërisë do të jetë:

- **Saimir SHEHU**, i biri i Fatmir, shtetas Shqiptar, lindur në Tepelenë dhe banues në Tiranë, lindur më 18/10/1989, madhor, me zotësi të plotë juridike për të vepruar, për identitetin e të cilët u garantova me pasaporte nr. BA0048719 dhe nr. personal I91018052W;

Shoqëria përfaqësohet para çdo organi administrativ, gjyqësor, enti publik apo privat dhe në marrëdhënie me të tretët nga administratorët, të cilët i ushtrojnë këto të drejta në përrputhje me Statutin e shoqërisë dhe legjisacionin në fuqi.

#### NENI 8

Eksperti Kontabël i Autorizuar i shoqërisë do të emërohet në përrputhje me legjisacionin përkatës në fuqi dhe për çdo vit financier shoqëria do të emërojë një ekspert kontabël për të kontrolluar aktivitetin ekonomik të shoqërisë.

#### NENI 9

Ortakët themelues mund të vendosin me vullnetin e tyre, përpjesemarrjen në Shoqëri të tjera dhe të krijojnë çdo lloj aktiviteti tjetër privat, me përjashtim të kufizimeve të përcaktuara me ligj.

**NENI 10**

Organizimi dhe funksionimi, i shoqërisë, ngritja e degëve apo filialeve të saj, do të bëhet në përputhje me dispozitat e ligjit përkatës dhe statutit.

**NENI 11****Legjislacioni i aplikuar**

Aktiviteti i shoqërisë do të rregullohet nga Statuti i firmosur nga ortakët themelues. Çdo gjë që nuk është parashikuar në Statut do të disiplinohet nga legjislacioni tregtar dhe nga dispozita ligjore në fuqi.

**NENI 12****Zgjidhja e Mosmarrëveshjeve**

Mosmarrveshjet që mund të lindin gjate aktivitetit te shoqerise zgjidhen me konsensus, ne te kundert palet i drejtohen gjykates kompetente.

**NENI 13****Dispozita Përfundimtare**

Akti i themelimit përpilohet në tre kopje të njëjtë në gjuhën shqipe.

**ORTAKËT THEMELUES**

Gëzim SHEHU



Saimir SHEHU

